

VENDIM
Nr.1055, datë 22.12.2010

**PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Për Projektet e Veprave
Të Ndërtimit**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponcë teknike.

2. Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, oponcë teknike do të bëhet nga subjekte publike studimore/shkencore, të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponcës teknike. Oponcë teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

4. Kërkesa për oponcë teknike bëhet nga investitori. Me miratimin e kërkesës, palët lidhin një aktmarrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës miratohen nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

5. Tarifat e oponcës teknike të projekteve të veprave të ndërtimit, të zbatohen duke iu referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministrinë, institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të gjitha organet e tjera investitore për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.363, datë 18.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponcës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyjn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

TARIFAT PËR Oponencën Teknike Për Projektet e Veprave Të Ndërtimit

Tarifat për oponcën teknike për projektet e veprave të ndërtimit i referohen tarifës në përqindje të projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

Kushtimi (milion lekë)	Tarifa (në %)
100,00	6.5
150,00	6.0
200,00	5.5
250,00	5.0
300,00	4.5
mbi 300,00	4.0